FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

BIKARBONAT NATRIUMI

Tretësirë për injeksion – 840 mg / 10 ml

(Bikarbonat natriumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Bikarbonat natriumi dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Bikarbonat natriumi
3. Si ta merrni Bikarbonat natriumi
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Bikarbonat natriumi
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË BIKARBONAT NATRIUMI DHE PËRSE PËRDORET

Bikarbonat natriumi 840 mg / 10 ml është një preparat që injektohet në venë. Përdoret për t'i kthyer trupit pH-in normal pas një arresti kardiak. Gjatë një arresti kardiak (ndalim i zemrës) në organizëm mund të grumbullohet një sasi e konsiderueshme acidi (acidozë metabolike). Bikarbonati i natriumit duke qenë alkalin, përdoret për neutralizimin e këtij aciditeti.
Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Bikarbonat natriumi për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj nëse doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI BIKARBONAT NATRIUMI

Mos e merrni Bikarbonat natriumi në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj bikarbonatit të natriumit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tretësirës për injeksion;
- vuani nga insufiçienca renale;
- vuani nga hipertensioni;
- keni edema;
- keni alkalozë respiratore ose metabolike;
- vuani nga mungesa e klorit ose hipernatremia;
- vuani nga insufiçienca kardiake kongjestive;
- keni hipokalcemi.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos e përdorni barin, shkoni dhe konsultohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, të tilla si:

- kortikosteroidë ose kortikotropinë;
- tetraciklinë, sepse alkalinizimi i urinës rrit klirensin renal të tetraciklinës, veçanërisht të doksiciklinës;
- kinidinë, amfetaminë, efedrinë dhe pseudoefedrinë, sepse administrimi i bikarbonatit të natriumit rrit gjysmëjetën e tyre dhe veprimin e këtyre barnave bazike.

Kujdes! Nga administrimi i njëkohshëm i bikarbonatit të natriumit me diuretikët që pakësojnë nivelin e kaliumit, si: tiazidikë, furosemid, bumetanid, acid etakrinik, mund të ndodhë alkalozë hipokloremike.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji

Nuk ka studime mbi përdorimin e sigurt të bikarbonatit të natriumit në gra shtatzëna. Ashtu si për çdo bar tjetër, përdorimi i bikarbonatit të natriumit në gratë shtatzëna apo në nënat që ushqejnë fëmijët me gji, kërkon që përfitimet që priten të merren nga mjekimi të mendohen mirë e të bëhet një balancë e kujdesshme me rrezikun e mundshëm ndaj nënës dhe fëmijës.
Nuk këshillohet dhënia e bikarbonatit të natriumit tek nënat që ushqejnë fëmijën me gji.

3. SI TA MERRNI BIKARBONAT NATRIUMI

Gjithmonë injektimi i këtij bari duhet bërë nga mjeku ose nga infermieri i ngarkuar për këtë punë.
Injektimi i Bikarbonat natriumi bëhet ngadalë në venë, në sasi që varen nga patologjia, bilanci acido-bazik dhe hidroelektrolitik si dhe gjendja e organizmit.

Në qoftë se keni marrë më shumë Bikarbonat natriumi

Si rregull nuk duhet të ndodhë një mbidozim nga ky bar meqenëse është një preparat që administrohet nga personeli mjekësor dhe nuk mund të merret në kushtet e shtëpisë. Megjithatë, në rastin e mbidozimit, simptomat e mundshme mund të jenë: alkalozë metabolike, hipokalemi e rëndë, hiperirritueshmëri dhe tetani.
Për mjekim në rastin e mbidozimit këshillohet ndërprerja e administrimit të bikarbonatit ose administrimi i kalçium glukonatit, veçanërisht nëse tetania është prezente. Në rastin e alkalozës së theksuar, rekomandohet një infuzion 2.14% i klorurit të amonit, duke përjashtuar pacientët me sëmundje të mëlçisë. Nëse hipokalemia është prezente, duhet administruar klorur kaliumi.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.
Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore! Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:

- nga përdorimi për një kohë të gjatë i bikarbonatit të natriumit mund të shkaktohet alkalozë dhe / ose hipokalemi, hipernatremi, hiperosmolaritet
- hiperirritueshmëri ose tetani;
- dhimbje lokale dhe nekrozë e indit për shkak të daljes së tretësirës nga vena.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI BIKARBONAT NATRIUMI

Mbajeni larg fëmijëve!
Ruajeni në temperaturë më të ulët se 25°C!
Shikoni afatin e përdorimit në paketim përpara përdorimit!
Mbrojeni barin nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Bikarbonat natriumi

Lënda vepruese është bikarbonati i natriumit.
1 ampulë 10 ml përmban 840 mg bikarbonat natriumi.
Përbërësit e tjerë: edetat dinatriumi, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 10 ampula.
Kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Merret vetëm me recetën e mjekut.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - Shqipëri

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Mars 2012.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.